



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:088040

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05754068

PKR.nr.174/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykes Alban Ajvazi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leutrim Hoti, në çështjen penale të pandehurve: S.B dhe S.B për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.840/12, të datës 30.03.2016, konform dispozitave të nenit 157 par.1, nenit 234 par.4 dhe par.5 dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, me datë 30.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.840/12, të datës 30.03.2016.

PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve:

I. S.B, nga i ati... dhe nëna..., i lindur me..., me vendbanim..., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. Personal... Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

II. S.B, nga i ati...dhe e ëma..., e lindur me..., me vendbanim..., ka të kryer shkollën e mesme, e gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal..., Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

Për shkak se aktakuza është ngrit pas afatit të paraparë ligjor.

I dëmtuari – dëshmitari A.E nga Klina, me vendbanim..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë nën shenjë PP/L.nr.840/12, të datës 30.03.2016, kundër të pandehurve: S.B dhe S.B për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPRK-së.

Gjykata me datën 23.05.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kishin prezantuar prokurori i shtetit dhe e pandehura S.B me mbrojtësin e saj sipas autorizimit av. Bekim Kelani, ndërsa kishte munguar i pandehuri S.B dhe pas shikimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se aktakuza e Prokurorisë nën shenjë PP/L.nr.840/12, të datës 30.03.2016, e cila është pranuar në gjykatë me datën 31.03.2016 është ngritur pas afatit të paraparë ligjor, pas përfundimi të afatit për fillimin e hetimeve, pasi që në rastin konkret Aktvendimi për fillimin e hetimeve është marr nga prokuroria me datën 03.11.2012.

Lidhur me këtë, gjykata ka ftuar prokurorin e shtetit që të deklarohej, i njëjti deklaroj se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë aktvendim për pezullimin e procedurës penale në këtë çështje penale.

Në nenin 541 par.1 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, thuhet se *“me fillimin e zbatimit, dispozitat e këtij Kodi zbatohen përshtatshmerisht për çdo procedurë penale pavarësisht fazës në të cilën gjendet”*. Pra ky nen e udhëzon gjykatën që në rastin konkret edhe pse procedura penale fillimisht ka filluar që të zbatohet me Kodin e Procedurës Penale me Nr. 04/ L-123, pas hyrjes në fuqi me datën 27.08.2022 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës me Nr. 08/L-032 me datë 01/01/2013, duhet të vazhdohet me këtë Kod.

Në bazë të dispozitës ligjore nga neni 157 par.1 të KPPRK-së, thuhet se *“nëse hetimi është filluar, ai përfundon brenda dy (2) viteve”*. E në rastin konkret në shkresat e lëndës nuk ka kërkesë për zgjatje të afatit të hetimeve dhe as vendim për pezullimin e hetimeve.

Në bazë të dispozitës ligjore nga neni 234 par.4 të KPRK-së, thuhet se *“aktakuza dorëzohet më së largu brenda tre (3) muajve pas kalimit të afatit të hetimit”*, po ashtu në par.5 të këtij neni thuhet se *“nëse aktakuza dorëzohet nga prokurori i shtetit pas afatit të paraparë në paragrafin 4 të këtij neni, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues e hedh poshtë aktakuzën”* e në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore të kësaj dispozite për pushimin e procedurës ndaj të akuzuarve, pasi që aktakuza është ngritur pas kalimit të afatit prej dy viteve të hetimeve, saktësisht me datën 31.03.2016, ndërsa prokuroria ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve me datën 03.11.2012. Gjykata ka gjet se në rastin konkret nga aktvendimi për fillim të hetimeve PP.nr.840-12/2012/12, të datës 03.11.2012, e deri te ngritja e aktakuzës me numër PP/L.nr.840/12, të datës 30.03.2016, është shkelur çdo afat i mundeshim ligjor dhe se ky veprim i prokurorisë përmban shkelje të natyrës procedurale.

Gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me këtë dispozitë ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 462 par.1 dhe par.3 të KPPK-së, palët e dëmtuara është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më larte në bazë të nenit 157 par.1, nenit 234 par.4 dhe par.5 dhe nenit 357 par.1, nënpar.1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënd
PKR.nr.174/16, datë 30.05.2024

Kryetari i Trupit Gjykes, Gjyqtari
Alban Ajvazi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa dhe mund të ushtrohet nga palët e pa kënaqura brenda pesë (5) ditëve, nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.